




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Pranuar - Primjeno Miri/Dana			
02.04.2010			
Mr. i organit	Numri/Broj	Shtojcë	Vlera
Org. broj		Prilog	Vrednost
01-013/1302			

Republika e Kosovës -Republika Kosova-Republik of Kosova

Komuna e Vitisë-Opstina Vitina-Municipality Vitina

RR E G U L L O R E PËR LEJE PUNE TË SUBJEKTEVE AFARISTE

Viti, 30 mars 2010

Duke u bazuar në nenin 40.2 nën a) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 38 të Ligjit mbi Tregtinë e Brendshme, Udhëzimit administrativ 2005/12 për përmbushjen e kushteve minimale teknike për lokalet afariste. nenit 22.2 nën a) të Statutit të Komunës së Vitisë, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2010 aprovon këtë:

R R E G U L L O R E

PËR LEJE PUNE TË SUBJEKTEVE AFARISTE

Dispozita e Përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet për lëshimin e lejes së punës, për punë për shoqëritë tregtare dhe subjektet ekonomike që ofrojnë shërbime që janë të regjistruar sipas ligjeve në fuqi mbi shoqërinë tregtare.

Definicionet dhe kuptimi i termave

Neni 2

Secili prej termave në vijim, kudo që përdoret në këtë rregullore, do të ketë kuptimin e dhënë, përveç nëse kontesti brenda të cilit një term i tillë paraqitet, nënkupton qartë diçka tjetër:

- Emërtimi »**Subjekt afarist** », sipas kësaj Rregullore nënkupton secilin person juridik që merret me aktivitete ekonomike të mbështetura në ligj me qëllim përfitimi.
- **Organi Kompetent Komunal**, nënkupton Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 3

- 3.1. Subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë afariste në territorin e Komunës së Vitisë, duhet të jenë të regjistruar sipas Ligjit mbi regjistrimin e biznesit në Kosovë.
- 3.2 Subjekti që ushtron veprimtari biznesi brenda Komunës së Vitisë duhet:
 - (a.) Për ndërmarrjen amë dhe për secilën njësi të ketë lejen e punës për ushtrim të biznesit. Leja e punës ka karakter personal dhe nuk mundet të bartet në personin e tretë.
- 3.3 Të gjitha aktivitetet afariste ekonomike në Komunën e Vitisë, duhet të kryhen në vend të caktuar dhe të përshtatshëm.
- 3.4. Asnjë subjekt afarist sipas kësaj Rregullore nuk lejohet të ushtroj veprimtarinë e vet afariste pa Leje pune nga Organi Kompetent Komunal.

Neni 4.

- 4.1 Subjekti afarist i cili i plotëson kushtet sipas nenit 3 të kësaj Rregullore, është i obliguar që të bëjë kërkesën për marrjen e lejes së punës në afat prej 30 dite, nga dita e pajisjes me çertifikatën për ushtrimin e biznesit, të lëshuar nga MTI-a (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë).
- 4.2 Në qoftëse objekti, instalimet, pajisjet dhe mjetet tjera të punës të subjekti afarist nuk i përgjigjen kushteve higjeno-sanitare dhe teknike, organi kompetent i inspekcionit do të marrë vendim të urdhërojë subjektin afarist për eliminimin e të metave të konstatuara duke cekur edhe afatin brenda të cilit duhet të eliminohen të metat e konstatuara.
- 4.3 Nëse të metat e konstatuara nuk eliminohen në afatin e caktuar dhe nuk njoftohet organi i inspekcionit atëherë subjekti i tillë do të detyrohet të ushtrojë kërkesë të re për verifikim të kushteve të ushtrimit të biznesit dhe të pajisjet me leje pune.
- 4.4 Në rast instalimet, pajisjet dhe mjetet tjera të punës nuk i përgjigjen kushteve në pikëpamje higjeno-sanitare-teknike, të mbrojtjes në punë, mbrojtjes së ambientit dhe mbrojtjes së konsumatorëve, organi kompetent i inspekcionit do të marrë vendim mbi ndalimin e përkohshëm të veprimtarisë deri në eliminimin e të metave.

Neni 5.

Për marrjen e lejes së punës të gjitha subjektet afariste janë të obliguar të sigurojnë dokumentacionin:

- a) Çertifikatën e regjistrimit të biznesit të lëshuar nga MTI-ja
- b) Lejen e ndërtimit, lejen e përdorimit apo aktvendimin e lokalit afarist të ndërtuar pa leje
- c) Subjekti afarist i cili është i vendosur në pronën shoqërore apo komunale kontratën mbi shfrytëzimin e objektit si dhe dëshminë mbi pagesën e taksës për m².
- d) Lejen për shndërrimin e objektit të banimit në afarist.
- e) Dëshminë me të cilën subjekti afarist dëshmon pronën e lokalit afarist ose kontratën mbi marrjen me qira të vërtetuar nga Gjykata.
- f) Dëshminë se i ka paguar të gjitha obligimet paraprake ndaj buxhetit komunal.
- g) Licencën e subjektit afarist të lëshuar nga Ministria gjegjëse (për ndërmarrjet prodhuese përpunuese-fabrikat dhe subjektet tjera).
- h) Aktvendimin e pranimit të lokalit nga ana e komisionit.
- i) Dëshminë e pagesës për marrjen e lejes prej **20€**.

Neni 6

Subjekti i biznesit duhet të paguajë taksë administrative për pranim teknik të lokalit nga Organi i Inspekcionit për vendimin mbi plotësimin e kushteve minimale higjeniko-sanitare dhe teknike sipas nenit 24 të Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoha numër 01-013/953 të datës 18.03.2010,

Neni 7.

7. a Organi kompetent Komunal, pas marrjes së kërkesës dhe konstatimit se kërkesa i ka të gjitha dokumentacionin e nevojshëm sipas nenit 5 të kësaj rregullore, në afat prej 15 ditësh merr vendim meritor sipas kërkesës.

7. b Organi kompetent mund të lëshoj lejen e punës në afat prej një viti edhe pa plotësimin e **nenit 5 b** me kusht që brenda një viti ta siguroj lejen përkatëse.

Nëse pala ka vërejtje në vendimin e organit kompetent komunal në afat prej 15 ditësh mund të ushtroj ankesë pranë MTI-së Departamentit të Inspektionit.

Neni 8.

a). Leja e punës ka karakter të përhershëm dhe do të vlejë nga data e lëshuarës përveç subjekteve afariste që zhvillojnë veprimtarin sipas nenit **5 pika c.** dhe nenit **7 pika b.**

Neni 9.

9.1. Leja e punës është e pa vlerë në këto raste:

9.2. Nëse subjekti afarist ndryshon adresën, bëhet ndërrimi i pronarit ose ndërrohet veprimtaria.

9.3. Afati për ndryshimin e lejes për rastet e përmendura në neni **9.2** të kësaj rregulloreje është 7 dite nga dita e ndryshimeve që janë bërë në certifikatën dhe listën e veprimtarive.

Neni 10.

Subjekti i biznesit është i obliguar që në lokalin e vetë afarist:

10.1 Të ketë lejen e punës, e cila duhet të ekspozohet në vend të dukshëm.

10.2 Të vendos mbishkrimin e subjektit të biznesit (titullin) në vend ndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë.

10.3 Të vendos çmimet në mallra në vend të dukshëm dhe në mënyrë që ato të jenë të lexueshme

10.4 Të lëshoj bllok paragona apo fatura për mallrat dhe shërbimet e bëra.

10.5 Të vendos në vend të dukshëm orarin e punës i cili do të jetë në pajtim me dispozitat e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës.

10.6 Të zhvilloj veprimtari biznesi në pajtim me lejen përkatëse të punës dhe me mbishkrimin e emërimit të subjektit afarist.

Dispozitat ndëshkuese.

Neni 11.

11.1 Nëse inspektori i tregut me rastin e kontrollit inspektues konstaton se subjekti afarist nuk ka leje të punës, personit përgjegjës i tërhiqet vërejtja dhe kërkohet nga ai që në afat prej 15 ditësh ta siguroj Lejen e punës.

11.2 Po qe se i përmenduri në afatin e cekur në alinenë 1. nuk e ka përmbushur këtë detyrim, ndaj tij inicohet procedura e kundërvajtjes pranë gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Viti .

11.3. Lartësia e dënimit është **70.00€**

11.4. Nëse edhe pas marrjes së masave të caktuara në alinen1, 2,dhe 3 të këtij neni subjekti përgjegjës nuk e siguron Lejen e punës, personat përgjegjës të organit kompetent komunal do ti iniciojnë procedurën për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë.

Neni 12.

Impementimin e kësaj Rregulloreje do ta bëjë Organi Kompetent Komunal përmes Shërbimit të inspektionit pranë Drejtorisë së Inspektionit.

Dispozitat kalimtare

Neni 13

Për të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore vlejnë Dispozitat e Ligjeve të aplikushme në Kosovë.

Neni 14.

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj rregullore bëhet në procedurë të njëjtë sikurse për aprovimin e saj.

Neni 15.

Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, çfuqizohet Rregullorja për leje të subjekteve afariste nr 01-020/3221 e datës 30.12.2003.

Neni 16.

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

Viti, 30 mars 2010



KRYETARI I KUVENDIT

Skenderbe Hëbib